



BULETINI ELEKTRONIK I SHOQATËS UJËSJELLËS KANALIZIME TË SHQIPËRISË

**SHUKALB**
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

Dhjetor 2016

Pasqyra e Eventeve

Konferenca dhe Ekspozita e 4-t Ballkanike e Përbashkët "Uji dhe Punësimi": Një sukses i madh për SHUKALB dhe SHUKOS



Më 2, 3, 4 nëntor, SHUKALB në bashkëpunim me SHUKOS (Shoqata e Ujësjetësve dhe Kanalizimit të Kosovës) organizoi Konferencën dhe Ekspozitën e 4-t Ballkanike të Përbashkët me temë "Uji dhe

Punësimi", te Expocity në Tiranë, Shqipëri. Eventi vjetor vërtetoi sërish statusin e eventit më të madh në ndarjen e informacionit dhe networking në sektorin e ujit në Ballkanin Perëndimor. Me një audiencë prej mbi 400 pjesëmarrës, që vinin nga 22 vende të ndryshme nga Ballkani dhe Evropa, dhe 70 moderatorë dhe folës, Konferenca arriti objektivin e saj për të nxitur dialogun midis aktorëve të ndryshëm. [lexo më shumë](#)

Çfarë ka të Re në SHUKALB!

E RËNDËSISHME: Planifikoni Trajnimin e Stafit tuaj, në Buxhetin e vitit 2017

Është koha që shoqëritë Ujësjetës Kanalizime në Shqipëri dhe Kosovë, të planifikojnë në buxhetin e vitit 2017, trajnimin e stafit të operimit dhe mirëmbajtjes. Marrëveshja e Mirëkuptimit që u nënshkrua në Konferencën dhe Ekspozitën e Përbashkët



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjetës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

Eventet e Ardhshme!

Mbledhja e Asamblese - Shkurt 2017

Bashkohuni me Ne!



Ballkanike do të sigurojë një program të përbashkët trajnimi për Shqipërinë dhe Kosovën, dhe që do të menaxhohet nga SHUKALB dhe SHUKOS.[lexo më shumë](#)

Profesionistët e Rinj të Ujit

Forumi i Profesionistëve të Rinj të Ujit



Një event mbresëlënës, organizuar përpara Konferencës më 2 nëntor, ishte Forumi i Profesionistëve të Rinj të Ujit, një platformë e hapur, e

adresuar për studentët, profesionistët e rinj të ujit, inxhinierët drejtues të ujit dhe njerëzit që mbulojnë një gamë të gjerë profesione, nga teknike, sociale, ekonomike dhe mjedisore, nën moshën 35 vjeç, të cilët punojnë apo janë të interesuar të punojnë në sektorin e ujit. Më shumë se 80 profesionistë të rinj të ujit nga Shqipëria dhe Kosova, morën pjesë në këtë event, duke përfaqësuar një gamë të gjerë të institucionesh dhe profesione.[lexo më shumë](#)

Baseni i lumit Drin: Burim i përbashkët dhe Përgjegjësi e përbashkët



Grupi i Profesionistëve të Rinj të Ujit (PRU) të Shqipërisë ka qenë i angazhuar në një projekt i titulluar " Baseni i lumit Drin: Burim i përbashkët dhe

Përgjegjësi e përbashkët". Projekti ka filluar në vjeshtë të vitit 2015 dhe ata e kanë zhvilluar, duke punuar ngushtë me dy grupe të ndryshme studentësh nga Institutit Politeknik Worcester (WPI) nga Shtetet e Bashkuara. Gjatë vjeshtës së vitit 2015, PRU sëbashku me grupin e studentëve të WPI-së së atij viti, ka kryer një hulumtim mbi karakteristikat fizike të lumit Drin si bazë për planifikimin e një "lundrimi" përgjatë lumit, për të dokumentuar përmes fotove lumin dhe për të



Na tregoni se cfarë mendoni!



intervistuar njerëzit që jetojnë, punojnë dhe argëtohen përgjatë lumit.[lexo më shumë](#)

Projekti “Zhvillimi i Qëndrueshëm i Kapaciteteve në Sektorin e Ujit në Shqipëri”

Përditësim rreth Grupit të Punës Ministror të Certifikimit



Grupi i Punës së Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës mbi Certifikimin, sëbashku me Grupin Këshillimor Teknik, u takuan me Grupin e Projektit

të SHUKALB me 9 nëntor, me qëllim marrjen e komenteve të institucioneve të ndryshme, si dhe të shoqërive ujësjellës kanalizime mbi draft dokumentet që Projekti ka përgatitur dhe ndarë, të cilat përshkruajnë kornizën institucionale si dhe aspektet teknike të Programit të Certifikimit Bazuar në Testim për Menaxherët Operacionalë në Sektorin e Ujësjetës Kanalizimeve në Shqipëri.[lexo më shumë](#)

Dr. Catherine Johnson, USAID takohet me Z. Sokol Dervishaj, Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës

Në vazhden e mbështetjes së konsiderueshme të siguruar nga USAID për Sektorin e Ujit në Shqipëri, përmes Projektit “Zhvillimi i Qëndrueshëm i Kapaciteteve në Sektorin e Ujit në Shqipëri”, SHUKALB kishte kënaqësinë të organizonte një takim mes Z. Sokol Dervishaj, Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës, institucioni kryesor që po udhëheq procesin e krijimit të Programit të Certifikimit Bazuar në Testim për stafin e shoqërive ujësjellës kanalizime në Shqipëri, dhe Dr. Catherine Johnson, Përfaqësuese e USAID në Shqipëri.[lexo më shumë](#)

Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, **Web:** www.shukalb.al